


2. Informacionit

1508 Prot.  
Datë 03.06.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
GJIROKASTËR

Nr.480/780 Regj.Them.

Datë 29.05.2026

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

Drejtuar: Bashkia Delvinë  
Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Për subjektin: **Sonilda Vaso**, person fizik

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Gjirokastër, është duke u gjykuar çështja civile me nr. 480/780 Regj.Them, që i'u përket palëve:

**PADITËS:** Shoqëria "ATLAS" sh.p.k, person juridik i themeluar dhe i organizuar sipas legjislacionit shqiptar, rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me NUIS J63317650C, Zyra Qendrore e Shoqërisë me adresë: Gjirokastër Gjirokastër Lazarat Fshati Lazarat, lagjia Kordhocë, rruga nacionale Gjirokastër-Kakavië, godinë 1- katëshe, nr. pasurie 84/91, zona kadastrale 2392, postë elektronike bashaca@basha.com dhe numër kontakti 0692032377.

**IPADITUR:** Sonilda Vaso, person fizik, rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me NUIS M17004501Q, me adresë: Vlorë Delvinë Delvinë, Lagjia "Sinan Ballaci", rruga "Javer Malo" godinë private 2-katëshe Nr.39 kati I-re, postë elektronike "sonildavaso476@gmail.com" dhe numër kontakti 0693597056.

**OBJEKTI:** -Detyrimin e palës së paditur të paguajë ne favor të paditësit shumën prej 1.276.766 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, detyrim që rrjedh nga faturat tatimore të shitjes me numra si mëposhtë:

1. Nr.626 datë 29.07.2023
2. Nr.671 datë 05.08.2023
3. Nr.708 datë 12.08.2023
4. Nr.754 datë 19.08.2023
5. Nr.11481 datë 23.08.2023
6. Nr.11569 datë 29.08.2023
7. Nr.11662 datë 02.09.2023

8. Nr.11771 datë 11.09.2023 në vlerë totale 1.276.766, si dhe pagimin e kamatvonesave ligjore për shumën përkatëse deri në ditën e ekzekutimit të vendimit.

-Ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore dhe avokatore palës së paditur.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, Nenet 419, 420, 421, 450, 455, 463, 663, 690, e vijues të Kodit Civil.

Gjykata pasi ezauroi etapat procedurale për njoftimin tuaj sipas neneve 129-133 të K.Pr.Civile, duke i'u njoftuar fillimisht në adresën në Vlorë Delvinë Delvinë, Lagjia "Sinan Ballaci", rruga "Javer Malo" godinë private 2-katshe Nr.39 kati I-re, adresë e cila rezulton sipas kërkesë padisë adresa juaj, letërthirja u kthye me shënimin "larguar". Gjykata vendosi të procedojë me njoftimin nëpërmjet shpalljes publike bazuar në nenin 133/a dhe 133/b, të K.Pr.Civile, duke u afishur një kopje e aktit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Gjirokastër si gjykata ku gjykohet mosmarrëveshja, një kopje në Bashkia Delvinë ku ndodhet vendbanimi juaj sipas akteve zyrtare, në QKB si dhe në faqen zyrtare të gjykatës.

Gjykata konform nenit 133/b të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: "...Njoftimi me shpallje publike kryhet me anë të afishimit të tij në gjykatën e vendit ku do të gjykohet mosmarrëveshja, në vendin ku personi të cilit i drejtohet njoftimi ka vendbanimin ose në vendqëndrimin e tij, si edhe në njësinë administrative në të cilën ka vendbanimin ose vendqëndrimin..."; vendosi të njoftojë me shpallje të paditurën subjektin person fizik Sonilda Vaso, për zhvillimin e seancës gjyqësore në datë **01.07.2026 ora 12:30**. Mosparaqitja e të paditurës të sipërcituar, në seancë gjyqësore, shkakton gjykim në mungesë, sipas ligjit. Kjo shpallje do të qëndrojë e afishuar në vendet e mësipërme minimalisht 20 (njëzet ditë) nga data e afishimit.

Gjithashtu, njoftoheni lidhur me faktin që nga pala paditëse është paraqitur kërkesë për pakësim objekti të kërkesë duke hequr dorë nga kërkimi për kamatë vonesat. Shpallja u dërgohet në dy kopje pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Bashkisë Delvinë, që kanë detyrimin të kthejë konfirmimin e shpalljes publike, një kopje afishohet në faqen zyrtare të Gjykatës, dhe një në stendën e Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Gjirokastër.

**GJYQTAR  
ERVIN KORE**

